



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

| | |
|------------------------|--|
| DATË/A: | 10.05.2024 |
| REFERENC-Ë: | 23/3300/MMPHI |
| PËR/ZA/TO: | N.T.P. "Tempo Petrol", Stacioni Karburanteve, Mramor, Prishtinë. |
| CC: | Komisioni për Leje Mjedisore |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim për Leje Mjedisore |



Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Tempo Petrol", Stacioni Karburanteve, Mramor, Prishtinë me Nr.Prot. 23/3300/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1. Vendimi për Refuzimin e kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore, N.T.P. "Tempo Petrol", për veprimtarinë: Stacioni Karburanteve, Mramor, Prishtinë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/3300/MMPHI
Datë: 10.05.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit N.T.P. "Tempo Petrol", Prishtinë i **Refuzohet** kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedisore për Stacionin e Karburanteve, Mramor, Prishtinë.

A r s y e t i m

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; <https://mmphi.rks-gov.net/>



- Pëlqim Mjedisor me Nr. 06/1583/1-ZSP-1426, të lëshuar me dt.02.05.2007

Operatori nuk ka plotësuar kushtet si më poshtë :

- Leje Ujore për shfrytëzim dhe
- Leje Ujore për shkarkim.

Komisioni për Leje Mjedisore në takimin e mbajtur të datës: dt.10.05.2024, konstatoi se operatori nuk i plotëson kriteret e parapara për pajisje me Leje Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë.

Andaj bazuar në faktet e cekura më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **Refuzon** kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore, në përputhje me nenin 12 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi



Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prishtinë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.